Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/454
Datë: 26.07.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 19.07.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet** "Shkolla Digjitale", SHPK Rr. Pashko Vasa nr 28 Lagjja Pejton 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 16.03.2023 deri 15.03.2028, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Programer junior, Niveli I sipas KKK,** lloji: Kualifikim i bazuar në standarde ndërkombëtare me 7 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 80 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 9 deri 20 kandidatë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Shkolla Digjitale" SHPK, për ri-akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi ri-validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për ri-validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për ri-akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.
Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit si vijon:

Salla 1, kapaciteti 20 kandidatë: 10 grupe/javë x 20 kandidatë = 200 kandidatë
Salla 2 kapaciteti 20 kandidatë: 10 grupe/javë x 20 kandidatë = 200 kandidatë
Salla 3, kapaciteti 20 kandidatë: 10 grupe/javë x 20 kandidatë = 200 kandidatë
Salla 4, kapaciteti 16 kandidatë: 10 grupe/javë x 16 kandidatë = 160 kandidatë
Salla 5, kapaciteti 16 kandidatë: 10 grupe/javë x 16 kandidatë = 160 kandidatë
Salla 6, kapaciteti 16 kandidatë: 10 grupe/javë x 16 kandidatë = 160 kandidatë
Salla 7, kapaciteti 16 kandidatë: 10 grupe/javë x 16 kandidatë = 160 kandidatë
Salla 8, kapaciteti 9 kandidatë: 10 grupe/javë x 20 kandidatë = 90 kandidatë

Numri total i grupeve brenda javës të shtrira në të gjitha sallat është 80, me numër të kandidatëve për grupe nga 9-20, me gjithsej 1330 kandidatë për një vit kalendarik.
Pra, numri maksimal i kandidatëve brenda një viti kalendarik është 1330.
Procesi i trajnimit zgjatë (10) dhjetë muaj, ndërsa në muajin korrik dhe gusht nuk vijon për shkak të pushimeve verore.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "Shkolla Digjitale" SHPK, Prishtinë;
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK